



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM
Nr. 39, datë 02.02.2021

**PËR NDALIMIN E KANDIDIMIT TË PROKURORIT GJERGJI CEKA PËR
LËVIZJE PARALELE NË POZICIONIN E PROKURORIT TË PROKURORISË
PRANË GJYKATËS SË SHKALLES SE PARË ELBASAN**

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 43, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të Ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 8 pika 1 germa ç), nenin 9 pika 1, germa a) të Rregullores “Për transferimin e prokurorëve nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele” miratuar me Vendimin nr.261, datë 17.11.2020 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si dhe në relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Ndalimin e kandidimit të prokurorit Gjergji Ceka në pozicionin e prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.
2. Relacioni shpjegues i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Të njoftohet për këtë vendim z.Gjergji Ceka.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga dita e njoftimit të vendimit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETARI

GENT IBRAHIMI

ANËTAR

KOSTAQ BELURI

ANËTAR

SANDËR BECI

ANËTAR

BUJAR SHESHI

ANËTAR

VATË STAKA

ANËTAR

ESMERALDA KESHI

ZV/KRYETAR

ALFRED BALLA

ANËTAR

NURIHAN SEITI

ANËTAR

TARTAR BAZAJ